

## INTERVISTË ME DR. ISMAIL BARDHIN PËR GAZETËN “HËNA E RE”

*1. Si dekan patët rastin që ta përcillni gjeneratën e parë të studentëve të Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup. A mund të na thoni se me ç'nivel të përgatitjeve profesionale na del kjo gjeneratë?*

**Dr. Bardhi:** Besoj se redaksia e gazetës “Hëna së Re” gjatë kohës që nga fillimi me punë i Fakultetit të Shkencave Islame ka pasur mundësi t'i vërejë rezultatet që i ka treguar, ose që është dashur t'i tregojë një institucion i lartë, siç është ky fakultet, që nga pjesëmarrja në aktivitetet shkencore e deri te kontributet e duhura në shkrime, prezentime e kështu me radhë, të cilat unë si dekan nuk i kam parë. Pra, sa i përket kësaj pyetjeje duket paksa se unë, të paktën lidhur me gjeneratën e parë të të diplomuarve, jam vënë në pozitën para aktit të kryer. Megjithatë, nga mirësjellja duhet të them se kam qenë i nderuar, dhe atë tepër i nderuar që ta kem një fat të tillë që të jem në krye të këtij institucioni më të lartë arsimor, e sidomos që kam përcjellur gjeneratën e parë të të diplomuarve. Me të vërtetë ka qenë e nevojshme të kremtohet, të shkruhet për atë moment për të cilin edhe studentëve të fakultetit ua kam folur, por për fat të keq kjo nuk u vërejt në shtypin tonë. Studentëve shpesh ua kam treguar rëndësinë e institucionit dhe rolin të cilin ata do ta kenë në të ardhmen, pa marrë parasysh se ky fakultet është i ri nga themelimi, por nga tradita është tepër-tepër i hershëm.

Mirëpo, pavarësisht nga ajo që thashë, nëse më pyetni se ku janë ato rezultate të lartëksuara natyrisht se ato mungojnë, për arsye se para se të nisë puna nuk është bërë analiza e duhur për themelimin e një institucioni të këtillë. Kohërat që po vijnë janë duke e vështirësuar akoma më tepër problemin e ekzistimit të nismave “të mira”, nëse ato nuk i plotësojnë kushtet e duhura, siç janë nevoja, koha, përgatitja, mirëmbajtja dhe vazhdimësia. Kur them përgatitja, mendoj në atë profesionale të kuadrit mësimdhënës, e deri te mirëmbajtja nga aspekti ekonomik. Në kohën kur shumë fabrika të njohura, të cilat kanë prodhuar dhe kanë qenë me nam për një çast janë zhdukur, nuk e di se si t'i përgjigjem suksesit dhe jetëgjatësisë të një institucionit kulturor, i cili jo që nuk prodhon, por është i “dënuar” të harxhojë.

Nuk është e mundshme ne të fillojmë duke iu mbështetur metodës së trishtueshme, më shtërpe, të stilit “meqë dikush ka, doemos duhet edhe ne të kemi”, ose asaj “më mirë diç se hiç”. Këto janë mbështetje mashtruese, natyra që moti këtë e ka bërë të vdekur, përpos në “mendësinë tonë”, e që për fat të keq një gjë e tillë në shumë drejtime akoma është duke vazhduar.

Përgatitja profesionale e studentëve për nga dashuria ndaj studimit dhe sukcesi i notave ka qenë për t'u lakmuar, por sa i përket aftësimin të tyre që t'u përballojnë sfidave të kohës, në këtë kohë të akulturizimit, të globalizimit, të “terrorizmit” dhe luftës kundër Islamit nuk mund të them gjë. Megjithatë, duke pasur parasysh problemet me të cilat janë ballafaquar studentët e fakultetit tonë, ku shumica e lëndëve profesionale teologjike janë ligjërues nga ligjërues të cilët nuk i kanë plotësuar as normat themelore të përcaktuara me Statutin ekzistues të fakultetit, nuk më mbetet gjë tjetër pos të diplomuarve tanë t'u uroj për zotimin e tyre në studime. Duhet pritur dhe parë rezultatet e tyre.

*2. Jeni i njohtuar me shumë planprograme mësimore të fakulteteve simotra në rajon e më gjërë! A i përshkon ato planprograme elementi i traditës së përgjithshme shpirtërore i secilit vend apo, ekzistojnë konturat profesionale mbi të cilat ngriten planprogramet e tilla? Ose, po qe se bëjmë një komparacion mes planprogramit mësimor të Fakultetit tonë dhe të atij të disa fakulteteve në rajon, në çka dallon planprogrami ynë!*

**Dr. Bardhi:** Për suksesin e institucionit si edhe të çfarëdo nisme, për çdoherë faktor kyç është aftësia dhe përgatitja profesionale e udhëheqësve, përgjegjësve të institucionit. Është fakt se plani dhe programi i mirë udhëheq dhe rregullon mirë, i ndihmon të mirës, por sa ka ekzistuar kjo te ne kisha thënë se pak i është kushtuar rëndësi, si nga ana jonë, mendoj në forcën teologjike, e pse mos të them se edhe nga ana e juaj, si burim informativ dhe korrigjues. Këtu vërehen lëshime të mëdha, të cilat kanë kaluar shkel e shko dhe meqë janë krijuar plane dhe programe të “çuditshme”, për arsye se jo që nuk janë përcjellur zhvillimet e duhura të kulturës me një vazhdimësi të plotë, por është bërë përpjekje që edhe vetë burimi të cungohet.

Planin dhe programin e punës së fakultetit, si dhe Statutin tonë, i ka përgatitur një trup punues, i cili pjesërisht është bazuar në planin e programin dhe Statutin e Fakultetit Teologjik Islam të Sarajevës, që është për t’u konsideruar si pozitive. Por, për planin dhe programin që në fillim të marrjes së detyrës para tre vitesh kam shprehur nevojën për përmirësimin, plotësimin dhe adaptimin e tij sipas normave, standardeve dhe kërkesave të cilat sot i përdorin shumë fakultete teologjike në Perëndim (këtu nuk mendoj vetëm në ato islame). P.sh. studimi i filozofisë dhe filozofisë së religjionit, sociologjisë dhe sociologjisë së religjionit, pedagogjisë, psikologjisë e madje edhe të ekonomisë islame pse mos të jenë të përfshira edhe në planin dhe programin e fakultetit tonë?

Sa i përket planit e programit dhe Statutit, tanimë Pleqësia e Fakultetit së bashku me Këshillin arsimor-shkencor i është rrekur punës për ndryshimet dhe plotësimet e tyre. Ndryshimet që parashihen të bëhen bazohen në përvojën e Fakultetit të Sarajevës, i cili ka dëshmuar sukses me rezultate shumë të mira, të cilat i kanë lakmi edhe fakultete edhe universitete, si islame ashtu edhe joislame, fetare dhe shekullare. Natyrisht se kam dëshiruar të konsultohem dhe kam kërkuar edhe planin dhe programin e Fakultetit Islam të Prishtinës, por ja që akoma nuk më ka rënë në dorë. Në takimet e mia me drejtuesit e këtij Fakulteti në Shkup, unë kam biseduar rreth kësaj çështjeje dhe atyre ua kam ofruar përmbledhësen e plotësimeve dhe ndryshimeve të planit dhe programit tonë, të cilin fakulteti ynë përpiqet t’i realizojë.

Lidhur me pjesën e pyetjes rreth traditës shpirtërore të planeve dhe programeve, do të thoja se ajo “traditë” nuk guxon të mbyllet në vetvete, por doemos duhet të përplasat me traditën e përbashkët botërore. Traditën nuk guxojmë ta cungojmë në gjuhë me shenja (si shurdhmemecët). Është me rëndësi se tradita që mësohet besimtarët tanë do t’i bëjë më të lezetshëm ndaj traditave të tjera, qoftë të vendit por edhe më gjerë. Natyrisht që me ndryshimet e parapara tradita jonë shpirtërore nuk do të lihet anash, por do t’i nënshtrohet një kritike qëllimshme.

E sa për dallimin e planit dhe programit tonë nga të tjerët, dhe që i ngarkon edhe studentët, është teprica e gjuhëve (shqip, maqedonisht, turqisht me osmanisht, arabisht, anglisht), disa prej të cilave do të përpiqemi t’i bëjmë fakultative.

*3. Është problem më vete avansimi i metodologjisë së punës në arsimin sipëror. Teknologjia bashkëkohore sot mundëson një zhvillim më efikas dhe më të shpejtë të proceseve arsimore. Mundësitë elektronike jo vetëm që i sjellin materialet mësimore në tavolinë porse mundësojnë që nga një distancë e madhe hapësirore të prezantojë në kabinet edhe mësimdhënësi. Pa dyshim që kjo metodë përdoret edhe për këmbim të ligjëratave akademike! Kemi ligjërues që elektronikisht mund të këmbëhet me një ligjërues boshnjak a shqiptar nga Kosova?*

**Dr. Bardhi:** Besoj se kur e parashtroni këtë pyetje, këtë e bëni me qëllim që ne të jemi më të kujdesshëm ndaj asaj që sot po ndodh në botë në aspektin e mundësive që bota moderne ia ofron studimit. Ne këtë e kemi parasysh, e shohim në televizion, por nuk kemi mundësi materiale për t'i realizuar kërkesat e prezentuara në pyetjen tuaj. Megjithatë, rreth metodës dhe metodologjisë në botën bashkëkohore janë duke u bërë analiza të shumta dhe nuk do të thotë se tërësisht pranohet çdo mundësi të cilën e ofron shkencat. Për disa, mendoj në shkencat ekzakto, janë të pranueshme; për sa u përket metodave të studimeve shoqërore, ku hyjnë edhe studimet teologjike nuk do të thotë se të njëjtat janë efikase, siç është edhe mësimi në distancë, më i njohur si *distance learning*. Metodologjia e vjetër në studimin e teologjisë doemos duhet ruajtur. Mundësitë të cilat i ofron teknologjia duhen shfrytëzuar në mënyrë racionale meqë nuk paraqesin *haram*.

Është për t'u lavdëruar zhvillimi i teknologjisë dhe ajo që është duke e ofruar sot. Ne si fakultet duhet të përgatitemi për një mundësi të tillë, e cila në mënyrë të gjallë do të krijonte kontakte me shumë fakultete e institucione shkencore, kulturore e informative si në vend ashtu edhe në botë. Por, këtu për fat të keq nuk kemi mundësi të bëjmë shumë me gjuhën shqipe, sepse nuk e di se në ç'mënyrë me gjuhën tonë do të mund të inkorporoheshim në rrjedhat bashkëkohore teknologjike, meqë për sa e di unë akoma nuk kemi ndonjë *software* në shqipe të programeve themelore (Edhe pse e di se sa i përket asaj metodës që ju e cekni për këmbim elektronik nuk është i nevojshëm program kompjuterik në shqipe). Për këtë dhe për shumë arsye të tjera më të rëndësishme insisto që në fakultetin tonë përpos gjuhës arabe, të mësohet edhe anglishtja dhe atë me një seriozitet shumë më të madh. Pa këtë ne nuk do të kemi mundësi t'i shfrytëzojmë lehtësimet ekzistuese, e mos të flasim për ato krijuese.

Për fat të keq, fakulteti ynë është edhe fizikisht larg mundësive të tilla. Ju e dini se gjendet në fshat, larg qytet(ërim)it, ku momentalisht akoma nuk e kemi të instaluar as rrjetin e Internetit. Kur mora detyrën në fakultet nuk kishte asnjë kompjuter. Sot të paktën administrata e fakultetit tonë regjistrohesh në kompjuter dhe besoj se së shpejti do të lidhemi në Internet.

*4. A është duke u punuar rreth asaj që, në një të ardhshme të afërt studentët tanë të kenë privilegjin që të mësojnë nga literaturat e autorëve tanë origjinalë! Për skicimin e mendimit shkencor tashmë ju keni themeluar edhe revistën shkencore. Do të mbetet revistë periodike apo keni potencial që ta bëni mujore?*

**Dr. Bardhi:** Kur dëshirojmë të flasim për atë se ç'presim në të ardhmen gjithsesi duhet që fillimisht të shohim se ç'na flet e kaluara. Përgjatë tërë historisë vërejmë mbytjen e njëres periudhë kohore nga tjetra, shkëputjen e gjallë mes tyre, që është një thirrje për intelektin tonë se ku është duke shkuar dhe ç'po ndodh me të? Periudha otomane është periudha më thirrëse për kokën dhe mendjen tonë që ta mbrojmë dhe ta rindërtojmë lidhshmërinë e kulturës sonë me të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Në këtë periudhë kemi shkrimin e parë, "Mesharin" e Gjon Buzukut, i cili i ka shërbyer dhe i shërben terminologjisë së teologjisë. Por në atë kohë kemi shkrime teologjike me vlera kolosale të shumë shkrimtarëve shqiptarë që kanë shkruar në gjuhët orientale. Ne me tërë fuqinë tonë këtë periudhë e përplasim vetëm se me çështjen e sundimit, domethënë politikën, ashtu që e kemi bërë të pamundshme për ta studiuar atë, natyrisht se flas për aspektin teologjik, e sidomos për atë islam. Paramendoni se ç'po ndodh me studimin e gjuhës osmanishte, sa studiues kemi të cilët e njohin rrjedhshëm këtë gjuhë, e cila ka përshkuar një periudhë kohore prej gati 6 shekujsh. Kjo zbrastësi nuk ka mundësi të mbushet vetëm me disa emra në tërë hapësirën shqiptare, të cilëve për fat të keq shumë pak u jepen merita. Duke iu bazuar kësaj periudhe ne nuk kemi mundësi të mburremi se e mbështesim lidhshmërinë, vazhdimësinë, kontaktin shpirtëror të teologjisë. Kjo është një çështje shumë domethënëse e cila ka një rëndësi të veçantë për ardhmërinë tonë. Mos dhashtë Zoti që dikush të mendojë se vetëm për arsye që

kjo periudhë ka qenë “islame”, neve të na prezentojnë si popull i cili jemi në shekullin XIV dhe se kemi filluar sërish të jetojmë vetëm pas vitit 1912.

Pas kësaj vijon periudha tjetër pas vitit 1912, një kohë e shkurtë deri në Luftën II Botërore ku vërejmë krijimin e gjallë të shkrimeve autoktone të autorëve tanë. Me paraqitjen e komunizmit ne e shohim e periudhën më paradoksale në përgjithësi. Asnjë gjëje nuk i ka pasur hije. Nëse kërkoni filozofi në atë periudhë nuk ka pasur të tillë, madje edhe ka qenë e ndaluar, përpos asaj marksiste dhe atë në formën e një specifikum-deliriumit. Me një fjalë unë nuk kam asgjë për të lexuar për teologjinë, flas për gjuhën shqipe, e ku më studentët e fakultetit.

Mos harroni se hapësira jonë e shkrimit, sidomos ajo e teologjisë, disa herë, mendoj për kohërat tona dhe pak para nesh, ka qenë e menduar mes fushës së ndalimit dhe lejimit, fushës së leximit dhe mosleximit. Dëshmi për këtë kemi njerëzit e gjallë të cilët akoma frymojnë në këtë botë. Pas gjithë kësaj fillon “fenomeni” i përkthimit dhe atë duke mos iu nënshtruar kritikës së duhur. Për këtë arsye kemi mundësi të themi se momentalisht studentët tanë lexojnë teologjinë “e përkthyer”. Nëse në mënyrë serioze u nënshtrohemi urdhërave të fesë, duke e pasur parasysh se çdo gjeneratë është përgjegjëse për kohën e vet dhe për të ardhmen, jemi të obliguar që të merremi me shkrime dhe krijime të reja, duke e shfrytëzuar Fjalën e Shenjtë si resurs i pashterrshëm për ndërtimin dhe rindërtimin e kulturës dhe pasurimin e fjalorit. Ne nuk do të kemi as filozofi pa zhvillimin e duhur të teologjisë. Nëse më lejohet këtu do të thoja se teologjia është një filozofi e përsosur me Zot, kurse filozofia është një urtësi pa Zot; por si njëra ashtu edhe tjetra janë domethënëse për zhvillimin dhe krijimin e teologjisë “së vendit, qytetit, kohës”. Fakultetet islame, gjegjësisht fakulteti ynë, kanë përgjegjësi të madhe për këtë.

E gjithë kjo që u tha nuk është imagjinatë; imagjinatë është kur tërë kultura mbështetet mbi letërsi, poezi dhe histori.

Sa i përket Përmbledhjes së punimeve të Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, qëllimi i tij ka qenë dhe mbetet t’u përgjigjet thirrjeve të shumta të së kaluarës, të së tashmes dhe të së ardhmes. Revista është në fillim e sipër, nuk guxojmë të jemi, e personalisht as që jam, të kënaqur me atë që është botuar brenda saj. Nuk jam i mendimit që këtë revistë ta bëj “të shpeshtë”, por vjetore ose më “të rrallë”. Do të isha shumë i kënaqur, por besoj se jo vetëm unë, në rast se cilësia do ta tejkalonte sasinë e artikujve të botuar në numrat e ardhshëm të saj.

*5. Zotëri Dekan, pa dyshim që jeni një ndër ata intelektualë të rallë në Maqedoni që vazhdimisht keni prezantuar në shtypin e ndryshëm ku keni trajtuar probleme të ndryshme! Jeni ndër të vetmit që keni apeluar për kapërcimin e krizës së identitetit në mesin e intelektualëve tanë! Ishte apel i guximshëm ky që dilte në kohëra të turbullta, kur mbase intelektualit e sheh më të arsyeshme që të heshtë! Në këto “kohë stabile” në ç’koeficient e shihni identitetin intelektual të akademikëve tanë dhe cila është peshë e zërit të tyre?*

**Dr. Bardhi:** Këtë lloj krize shpesh herë e kam analizuar së bashku me kolegët e fakultetit dhe studentët, duke thënë se si duket Zoti kulturës njëherë për njëherë ia ka “nxjerrë” shpirtin. Kjo do të thotë se nuk jemi pa kulturë, pa intelektualë, por që shpirtin e saj nuk po e vërej. Për momentin, më duket se kultura është bërë më tepër bajate sesa me peshë. Nëse flas me gjuhën e ekzegjës kur’anore, kultura siç duket gjendet në hapësirën e abrogimit.

Sa i përket intelektualëve, apo krizës së identitetit të tyre, ekziston një dallim i madh në mendimet rreth rolit dhe përgjegjësisë së intelektualëve. Në realitet, njerëzit rreth kësaj çështjeje mendojnë në dy mënyra: nga njëra anë roli i intelektualëve mbivlerësohet, mbithekskohet dhe absolutizohet – intelektualët konsiderohen si inxhinierë të shpirtërave njerëzorë dhe si krijues idesh, krijues të mendimit publik dhe si sundues joformalë të ngjarjeve shoqërore. E nga ana tjetër, kemi një nënçmim dhe mohim të plotë të rolit të intelektualëve edhe në qarqet intelektuale edhe në ato jashtintelektuale. Në rast se në të

kaluarën themel i shoqërisë mesjetare ka qenë toka, në kohët e reja kapitali – vlera, është më se e sigurt se themeli i shoqërisë së këtij shekulli të ri do të jetë dituria dhe imagjinata. Që këtu edhe mbivlerësimi dhe absolutizimi i intelektualëve. Mirëpo, ashtu siç e ndjek hija dritën, ashtu edhe këtë “hyjnizim” e ka ndjekur satanizimi i intelektualëve. Kjo sidomos ka ardhur në shprehje në regjimet totalitare të cilat kanë pasur aversion ndaj intelektualëve. Tek ne, mendoj në hapësirën shqiptare, më duket se është përdorur metoda staliniste e cila thotë: “shtoji intelektualët me qëllim që t’i poshtërosh”.

Kur flasim për intelektualin tonë përpos problemeve të shumta duhet ta kemi parasysh edhe problemin e “treshit” të tij, varësisht se nga cilat troje tona vjen. Intelektuali ynë gjithmonë është gjendur mes kombëtares dhe shtetit; atje ku është orvatur ta bëjë prezentimin e tij duke mbrojtur identitetin, kulturën përballë vetes e ka pasur shtetin, i cili e ka “zbritur” për toke dhe anasjelltas. Intelektuali shqiptar i Shqipërisë njëherë për njëherë mbetet i pakuptuar, së pari për arsye të “moslirisë” në të kaluarën dhe së dyti për arsye të “lirisë” që e ka sot. Sa i përket hapësirës intelektuale kosovare, ajo vazhdimisht ka hapëruar dhe vazhdon të hapërojë akoma pa u stabilizuar gjendja ose fati i saj. Edhe për hapësirën tonë intelektuale në Maqedoni mund të thuhet pothuajse të njëjtat gjëra si më sipër, me të vetmin dallim se tek ne kemi një numër shumë shumë të kufizuar të intelektualëve.

Çështja më kryesore këtu është se ne duhet t’i kemi parasysh rezultatet intelektuale të cilat e kemi shumë vështirë t’i shohim, ndërsa e vetmja mënyrë që inteligjencia jonë ta dëshmojë ekzistimin e vet intelektual e kulturor është përmes rezultateve. Urdhëroni dhe prezentoni pjesëmarrjen tonë intelektuale që nga shkencat ekzakte e deri te ato shoqërore, me përjashtim të letërsisë, poezisë dhe historisë kombëtare, e lëre më të mendojmë se në ç’mënyrë akademike mund t’i kontribuojmë shkencës, duke ofruar gjëra apo mendime të reja. Ashtu është kur intelektualit del jashtë dimensioneve të së vërtetës.

Nuk është për t’u habitur se ne këtë moment përpiqemi ta kapërcejmë disi duke bërë lavdërimin e disa ekspertëve tanë në diasporë, disa prej të cilëve nuk dijnë as shqip, dhe të pretendojmë se i kemi dhënë shumë shkencës botërore. Më falni, por e kam doemos ta them edhe këtë se më duket që ne më mirë dijmë ta çmojmë “intelektualin” në të kaluarën dhe pas vdekjes. Kjo është për t’u habitur.

A nuk është për t’u habitur dhe për keqardhje edhe fakti se pozita e kulturës, e shkencës dhe e intelektualëve tek ne i është lënë zhvillimit individual, përpjekjes individuale. Unë nuk kam të dhëna për finansimin e projekteve shkencore tek ne, me një fjalë sa dhe çka i garanton vendi dhe shteti intelektualit shqiptar për t’iu përgjigjur shkencës në mënyrë adekuate, në mënyrë intelektuale. Kjo mënyrë e zhvillimit shpie deri te ajo që ne vetëm të prodhojmë “të diplomuar”, duke filluar nga ata për kryerjen e studimeve e deri te titujt shkencorë. Besoj se ashtu siç ia kemi nisur dalëngadalë do të kemi edhe “doktorë shkencash privatë”, “akademikë privatë”. Për nga numri i diplomave, e kohëve të fundit edhe të titujve, besoj se zëmë vend të merituar në Evropë, por edhe më gjerë. E nga ana tjetër a nuk jeni duke e vërejtur se intelektualit ynë sot është në gjendje të mjerueshme, mendoj sidomos në aspektin ekonomik? Natyrisht këtu mendoj në intelektualët e mirëfilltë të cilët i plotësojnë standardet për t’u quajtur të tillë.

*6. Kombi ynë karakterizohet me një tolerancë të fuqishme ndërfetare. Mbase për shkak të trekonfesionalitetit të vet! Së këndejmi, kur të kihet parasysh ky fakt, a mendoni që tema “kombi apo feja” është një problem pseudointelektualësh?*

**Dr. Bardhi:** Para ca kohësh lexova një libër të R.M. dela Roccas “Shqipëria – rrënjët e krizës”, ku në një vend ai thotë: “Karakteristikë e shqiptarëve është edhe një lloj naiviteti, një qëndrim pasiv përballë modernes, një mangësi fryme kritike. Kam vënë re shpesh herë në Shqipëri (edhe tek ne – v.j.) që filmat merren jo si trillim, por si ngjarje reale që kanë ndodhur me të vërtetë, a thua se nuk ekziston një skenar, por po jepet realiteti i filmuar drejtpërsëdrejti. Edhe vetë lajmet qarkullojnë në Shqipëri (vlen edhe tek ne – v.j.) nëpër dy

pista: atë të mjeteve të informacionit dhe atë të popullit: flitet, përshpëritet, dalin fjalë dhe fantazia kthehet në fakt real, në diçka që ka ndodhur realisht përderisa të gjithë e tregojnë.”

Shumë interesante. Këtë libër ua kam prezentuar edhe studentëve të mij. Ta them të drejtën edhe me kaq do të ishte e mjaftueshme përgjigjja, por për arsye se disi tregoj pranimin e një vlerësimi të tillë, detyrohem t’ju them se shumë thënie, duke filluar nga: ‘feja e shqiptarit është shqiptaria’, ‘ndalimi i fesë’, ‘shkatërrimi i kishave dhe xhamive’, nuk kanë qenë të thëna apo kryera nga joshqiptarët. Fjala metaforike e Pashko Vasës, e cila meriton vlerën artistike-letrare fatkeqësisht është bërë argument i përhershëm i ‘inteligjencies’ sonë. Këtë thënie, si dhe shumë të tjera, tek ne “i ha pazari”, por thelbi, fjalori, kultura tallet me to.

Besoj se ne këtë çështje, e cila është me rëndësi edhe në hapësirën tonë të Maqedonisë, duhet ta analizojmë mirë dhe ta prezentojmë ashtu siç është. Tek ne me vite të tëra ka munguar një dialog i duhur ndërreligjioz, mendoj në atë në hapësirën e feve qiellore. Ne, dy popujt shumicë, fare nuk njihemi brenda vetë Maqedonisë, e mos të flas për paragjykimet të cilat i kemi për njëri-tjetrin. Ato janë nën çdo nivel. Në një bisedë kam thënë se ato paraqesin krizë të arsyes dhe intelektit tonë mendor. Nuk kam mundësi mos ta them edhe këtë se në ç’pozitë janë shqiptarët me fqinjët, nga rrjedh ajo urrejtje e paparë që na rrethon? Natyrisht se është çështje për t’u diskutuar dhe të hidhet në koshin e krizës së mendjes, por është mirë që edhe ne ta vëmë gishtin në kokë dhe të mendojmë se pse largohen të tjerët nga afrimi me ne kur ne çdo send e kemi flijuar dhe e flijojmë për të qenë të afërt. Kultura jonë nuk guxon ta kultivojë urrejtjen, e aq më pak që këtë ta bëjë feja.

Vështirësitë e shumta disa herë më përplasim me hapësirën e kontradiktës, por e kam të domosdoshme ta them edhe atë që e përjetoj, që e vërej si mangësi dhe keqpërdorim që i bëhet trungut tonë, fundi i fundit njeriut. Mu për këtë arsye shumë mirë e keni thënë se çështja “kombi apo feja” është në vete pseudointelektuale.

Sa i përket trekonfesionalitetit, këtë nuk e them për arsye se është mirë politikisht të thuhet, por nga bindja se me të vërtetë kjo dukuri duhet të çmohet dhe t’i jepet vendi i merituar, si për nga dimensionin fizik ashtu edhe shpirtëror i tij. Këtë e kam prezentuar edhe në njërin nga shkrimet e mia, duke thënë se kjo duhet marrë si paradigmë pozitive për të tjerët. Megjithatë, bota nuk i pranon përrallat tona lazdruese pa rezultatet e duhura, mendoj në ato vërtetë intelektuale e kulturore të hapësirës së teologjisë, meqë flasim për konfesionalitetin.

Kur jemi të rrethuar dhe të ballafaquar me problemin e konvertimit fetar e, pse mos të themi, edhe asimilimin kombëtar, e nga ana tjetër atë fushën fetare/teologjike mundohemi ta izolojmë nga hapësira shpirtërore e jona, atëherë paksa tingullon irrituese toleranca fetare dhe koncepti kulturor e shtetëror i ynë. E tërë hapësira e Shqipërisë sot vlon prej misionarëve, e njëjta ndodh edhe në Kosovë, me të vetmin dallim se këtu detyrën e misionarëve e kryejnë madje edhe fituesit e çmimit “Saharov”. Derisa ne nuk do ta kryejmë obligimin e duhur, si kulturor ashtu edhe politik, ne për çdoherë do të ballafaqohemi me kriza të mëdha, pavarësisht se si komb kemi shumë gjëra të çmuara për t’i prezentuar brenda dhe jashtë. Natë e ditë mbi ne qëndron rreziku e për fat të keq ne nuk jemi të vetëdijshëm për këtë.

*7. Globalizimi si fenomen po zhvillohet me tendenca të shtrirjes anekënd botës dhe në çdo sferë të jetës shoqërore. Në cilin kënd të këtij globalizmi të përgjithshëm e shihni shqiptarin musliman?*

**Dr. Bardhi:** Nuk e di se sa është e udhës të flasim për çështjen e globalizmit, për arsye se ajo është një çështje në vete të cilës i kushtohet rëndësi e veçantë. Dimensionin më kryesor i tij është ai ekonomik, për të cilën unë nuk kam se ç’të flas, por një gjë e kam të qartë se ekonomikisht të varfërit brenda procesit të globalizimit vetëmse do të vazhdojnë të varfërohen, tjetërsohen dhe, kam frikë, të zhduken. Këtu humb ajo ekonomia nacionale, nëse ka ekzistuar si e tillë. Dtt., globalizmi në aspektin ekonomik shqiptarëve po ua merr një pjesë shumë të rëndësishme për ekzistencën e tyre dhe për fat të keq proceset e tilla nuk

mashtrohen shumë shpejtë nga rezultatet ekonomike të vendeve të ndryshme, të cilat deklarojnë rritje ekonomike e nga ana tjetër nuk “prodhojnë” gjë pos “perimeve, kioskave dhe kafeneve”. Këtu dëshiroj ta cek se paradoksalisht ne shqiptarët jemi pjesëmarrës në globalizëm vetëm me muzikë dhe krim.

Ana e globalizimit që më intereson dhe që më thërret të mendoj është pjesëmarrja jonë në zhvillimet shoqërore në përgjithësi dhe këtu do të përqëndrohem mbi këtë jo vetëm si teolog por edhe si besimtar, duke filluar nga fenomeni i Islamit brenda globalizmit. Islami si fe që nga fillimi i vet e ka pasur të domosdoshme t’i nënshtrohet thirrjes së përgjithshme, pa marrë parasysh vendin, kohën, ngjyrën, e ky është elementi më kryesor që e përmban edhe globalizmi. Islami prej fillimit e deri në mbarim e ka të domosdoshme t’i bashkohet këtij procesi i cili momentalisht njihet në këtë formë. Veçantitë e ndryshme vetëmse e pasurojnë këtë fenomen qiellor. Këtë pozitë e kanë edhe Judaizmi e po ashtu edhe Krishtërimi. Këtu nuk kam mundësi t’ju them se ne si teologë sa e kemi dhe sa jemi duke e ndjekur këtë proces, dëshmi për këtë i kemi rezultatet të cilat tregojnë në një mënyrë mjerimin tonë. Sot nuk ka vend, do të thoja as qytete më të mëdha në botë ku nuk bisedohet për çështje me rëndësi, duke filluar prej atyre fundamentale teologjike e deri tek ato periferike. Është fakt se teologjia sot është tepër e ngarkuar në dimensionin e nevojave të demokracisë, politikës të cilat disi përpiqet t’i ngjyrosë ose t’i bekojë me bekimin fetar. Natyrisht se kjo është një sfidë për teologun musliman i cili është njeri që duhet të jetojë jetë shpirtërore, i shtyrë nga interesi që botën ta njohë dhe ta konceptojë, e jo që me të të sundojë ose ta shfrytëzojë për interesa të tjera. ä

Ne si muslimanë shqiptarë këtë proces jemi duke e kaluar të ballafaquar me pengesa të mëdha, për arsye se politika aktuale nuk është duke treguar ndonjë interesim të duhur, e pse mos të them se disa herë është duke u treguar si mbyllëse e dyerve të pjesëmarrjes sonë në këtë proces. Nëse kësaj ia shtojmë edhe paaftësinë atëherë vetvetiu kuptohet se ç’mund të ndodhë. Ne si muslimanë e kemi të domosdoshme të komunikojmë me gjithë botën, si me atë islame ashtu edhe joislame. Momentalisht si çështje shumë aktuale është edhe ajo e riformimit ose rikthimit të hilafetit si forma më adekuate e komunikimit me globalizmin. Për fat të keq shumë gjëra të mira, përpjekje pozitive janë duke ndodhur në vende të ndryshme, e ne për ato dëgjojmë me vonesë ose fare nuk i njohim. Më e keqja është se forca organizative institucionale dhe përfaqësuese e muslimanëve shqiptarë, nuk është duke treguar ndonjë strategji të duhur përgatitore për mundësimin e pjesëmarrjes sonë pozitive brenda zhvillimeve të globalizmit. Këtu do ta kisha përfshirë edhe Fakultetin e Shkencave Islame i cili në mënyrë tejet simbolike orvatet t’i përgjigjet kësaj sfide, megjithëse “fuqia” e globalizmit është duke e treguar edhe anën tjetër të saj, që vetvetiu tregon në zhdukjen e saj.

*8. Forma e jashtme që po sajohet nga elementet identifikuese të devotshmërisë muslimane, pa dyshim që ka filluar të ngjallë një reagim të shumë pushteteve në botë. Si më e guximshme po del Franca e cila po thirret në disa “masa sigurie” turke të aplikuara herë pas here kundër formës.*

**Dr. Bardhi:** Më pëlqeu shprehja juaj “‘masa sigurie’ turke”. Ashtu ndodh kur liria, demokracia përpiqen të dalin nga vetvetja në formë ndalesash. Unë këtu më tepër e shoh lëshimin në hapësirën me popullatë muslimane të shteteve të ndryshme, sesa në atë ku për nga numri muslimanët konsiderohen ‘pakicë’. Shpeshherë kanë ndodhur keqpërdorime të tilla e madje akoma më të vrazhda dhe do të thoja më banale, ku disa herë është kërkuar edhe leje fetare për një gjë jofetare ose të ndaluar në fe. Sidoqoftë, këtu problemi nuk buron nga gjeni fetar ose nga vetë feja, por janë demokracia dhe politika e disa shteteve që akoma nuk janë mësuar të jetojnë sipas normave demokratike. Demokracia në formë despotizmi nuk është demokraci, e as liria në formë të jolirisë nuk është liri. Për fat të keq ne ballafaqohemi me momente shumë më të rrezikshme sesa çështja e parashtruar nga ju, apo mbulesa, siç është shprehja e lirë dhe liria e muslimanëve nëpër vendet muslimane. Mos harroni rastin e

Irakut dhe të Libisë, por edhe të disa shteteve të tjera, që janë shembuj nga të cilët duhet të rrënoqethemi, e pse mos të themi edhe të turpërohem i që e “prezentojnë” Islamin.

Pozita e tillë është shumë e përshtatshme për keqpërdorimin e intelektualit musliman. Paramendoni se sa është e kuptueshme nëse ai nuk është i lirë e në anën tjetër përpiqet të prezentojë lirinë. Akoma më e vështirë është mendësia aktuale ku për një çast krijohet miti jo i arsimuar, me çka liderizmi fetar vetëmse mitimizohet. Ju jeni duke e parë se ç’është duke ndodhur edhe me disa çështje islame për të cilat pa referencat e duhura prezentohen, shtjellohen dhe, do të thoja, edhe zhvishen, siç është rasti i femrës (mbulesa, shkurorezimi, poligamia etj.), të cilat tashmë janë bërë tema bajate. Këtë do ta quaja mjerim i arsyes dhe kulturës fetare e traditore për shumë vende me popullatë shumicë muslimane.

Sa u përket vendeve perëndimore ne kemi çështje që janë shumë diskutabile: pranimi i fesë si fenomen dhe prezentimi i fesë si fenomen gjendet brenda paqartësive të mëdha, që fenomenin e fesë e largon nga burimi i saj, me vetë paraqitjen e fraksioneve të ndryshme e deri te “krijimi” i feve të reja. Me një fjalë, gjeni monoteist është në dridhje e sipër, dhe fetë qiellore e kanë të domosdoshme që në mënyrë serioze të kyçen në këtë problematikë dhe besimtarët mos t’i lënë brenda hutive dhe “tmerrit” të metafizikës.

Muslimanët e Perëndimit në mënyrë shumë të kulturuar janë duke e prezentuar të metën dhe mangësinë e demokracisë, rrezikun e “lirisë” dhe të padrejtësisë. Natyrisht, ajo që sot u ndodh atyre nesër do t’u ndodhë të tjerëve, por unë mendoj se “liderët” muslimanë të hapësirave muslimane nuk do të bënin mirë po nëse eventualisht mundohen ta ngrisin vetveten në një pedestal më të lartë vetëm duke i sulmuar të tjerët, e nga ana tjetër ta harrojnë thirrjen më të rëndësishme të fesë që t’i kthehen vetvetes e të korrigjohen.

*9. Këto ditë u luajt një lojë tepër e rrezikshme në Maqedoni, e cila kaloi pa u vërejtur nga provenienca e shoqërisë sonë muslimane! U inskenua një “përçarje” false në Kishën Ortodokse Maqedonase me të vetmin qëllim që problemi të ngritet deri në instanca më të larta shtetërore! Me këtë problem u mor Kryetari i shtetit, Qeveria dhe u debatua edhe në Kuvend! Nuk ju kundërmon ky problem në qëllimin e arritur për të dëshmuar se Maqedonia është shtet ortodoks për ortodoksinë e së cilës duhet të angzohen e të jenë syçelë të gjitha organet më të larta shtetërore?*

**Dr. Bardhi:** Duke u mbështetur në thënien tuaj për këtë lloj “inskenimi”, ne duhet ta dijmë se shumë inskenime kanë ndodhur në të kaluarën dhe akoma po ndodhin, të cilat janë duke kaluar shkel e shko. Neve pa nevojë u munduan të na armiçësojnë, duke na prezentuar kinse luftojmë njëri me tjetrin – paramendoni se si ka mundësi të zhvillohet jeta nëse një armiçësi e tillë luftarake ekziston brenda nesh? Edhe kjo kaloi shkel e shko, duke lejuar vetë ne që me këtë të krijojmë dhe ngrejmë mite dhe gjëra paradoksale, të cilat e kemi shumë vështirë t’i argumentojmë racionalisht.

Është e vërtetë se diçka po ndodh prapa skenës. Vështirësia është se si të flasim ne për këtë, kur nuk e dijmë. Mu për këtë arsye kërkohet transparencë e vërtetë. Vendet, njerëzit, asnjëherë as që do të krishterizohen e as që do të islamizohen, ata gjithnjë janë në shërbim të së Vërtetës. Të gjitha inskenimet e këtilla, që në vete shpesh përmbajnë edhe elementin e dhunës, në fund gjithmonë kanë dështuar.

Çka na intereson neve këtu? Ne duhet që në mënyrë të sinqertë, me bindje të thellë dhe rationale t’i nënshtrohemi Perëndisë. Nëse kjo ndodh, ne nuk kemi nevojë të frikësohemi nga inskenimet e ndryshme, do të thoja që as të merremi me to, qofshin edhe të llojit që ju e përmendni.

Kjo që po ndodh me Kishën Ortodokse Maqedonase sot, duke mos u thelluar në brendësinë e normave të tyre kanonike, vërtet është çështje e cila duhet t’i lihet asaj për ta zgjidhur. Ne nuk duhet të gëzohemi e lëre më t’i përmbajmë ndarjet të cilat shkaktajnë çrregullime, sepse çdo ndarje institucionale është e dëmshme. Kisha Ortodokse Serbe një kohë të gjatë në

mënyrën më të tmerrshme është duke i shërbyer politikës më destruktive në hapësirat tona, madje duke e përkrahur edhe gjenocidin.

*10. Për cilën iniciativë do të ishit Ju, si akademik: për zgjerimin e FSHI në Universitet Islam me disa Fakultete shkencore, apo për inkuadrimin e FSHI në ndonjë nga Universitetet tona eksistuese?*

**Dr. Bardhi:** Problemi nuk qëndron në atë se a duhet zgjeruar fakulteti në universitet islam e as fakultetin islam për ta inkuadruar në ndonjë nga universitetet. Këto janë çështje administrative. Por, për të ekzistuar një institucion si Fakulteti i Shkencave Islame ai paraprakisht duhet t'i plotësojë kushtet dhe standardet konform kërkesave të kohës. Në kohën e sotme në vend të parë vjen mbështetja ekonomike, apo finansimi, siguria e tij për të vazhduar së ekzistuari dhe përgatitjet profesionale të kuadrit adekuat të institucionit. Natyrisht se këtu bëjnë pjesë koha, vendi, mundësia, përgatitja, kuadri, ardhmëria e shumë faktorë të tjerë.

Nëse ekzistojnë këto ne fare nuk do të kemi problem për konkretizimin e idesë së tillë. Ne sot e kemi fakultetin, edhe pse siç thashë më lart për mua hapja e tij ka qenë hap shumë "i guximshëm", që nuk do të thotë se ne duhet të merremi me të kaluarën e tij. Ç'duhet bërë sot dhe nesër me fakultetin? Kemi bërë disa aktivitete të rëndësishme, duke filluar që nga prezentimi i fakultetit një trupi të madh botëror të sociologëve të religjionit, teologëve dhe udhëheqësve fetarë. Jemi duke përgatitur Statut më të kompletuar dhe plan e program më të përshtatshëm, të cilët do t'i aftësojnë teologët tanë për përballimin e sfidave të sotme dhe të nesërme. Si dëshirë ekziston që mësimi në fakultet të ndahet në dy drejtime: ai i teologjisë dhe i pedagogjisë fetare. Bashkëpunimi me fakultetet islame në Sarajevë dhe Prishtinë tashmë është vendosur, po ashtu edhe me fakultetin teologjik ortodoks në Shkup, me të cilin së shpejti do të kemi shkëmbime ligjëratash nga ligjërues të të dy provinencave. Koha na thërret që të mendojmë për krijimin e katedrave të shkencave islame brenda fakultetit tonë.

Duke iu kthyer pyetjes suaj për inkuadrimin në ndonjë nga universitetet në vend ne duhet ta dijmë se vendi i teologjisë ka qenë dhe do të mbetet vendi më i çmuar në tërë historinë e zhvillimit të kulturës dhe të mendimit njerëzor. I këtillë ka qenë fati i kulturës. Nëse kultura dëshiron të jetë e gjallë dhe me shpirt ajo, siç do të thoshte teologu i provinencës katolike Shagi Buniq, doemos duhet të jetë në shërbim të teologjisë ("çdo gjë duhet t'i shërbejë teologjisë"). Roli i teologjisë dita-ditës është duke u rritur dhe atë në mënyrë pozitive. Fakulteti ynë detyrën kryesore e ka që t'i plotësojë kushtet që vetveten ta pranojë dhe të përgatitet të futet brenda rrjedhave të sotme shoqërore, gjegjësisht intelektuale fetare. Për këtë arsye së shpejti fakulteti ynë do të organizojë një tryezë të rumbullakët rreth reformave dhe nevojave të arsimit brenda bashkësive fetare islame në trojet tona, ku mes tjerash me siguri do të shqyrtohen edhe perspektivat e fakultetit tonë brenda sistemit arsimor universitar.

Intervistoi Avni Halimi

Shkup, 30.01.2004